

**PROCESVERBAL**  
**nga seanca e 40-të e Këshillit të Agjencisë**  
**për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele**  
**e mbajtur më 20.10.2022**

**Anëtarë të pranishëm të Këshillit të Agjencisë nëpërmjet lidhjes video-konferencë:** Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr.Alma Mashoviq, dr.Metodija Jançevski, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

**Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /**

**Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dr.Zoran Trajçevski drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.**

**Të pranishëm nga Shërbimi profesional nëpërmjet lidhjes video-konferencë:** Cvetanka Mitrevska, mr.Emilija Janevska, mr.Arben Saiti, mr.Ruzhica Boshnakoska Jotevska, dr.Ilvana Stojanovska.

**Të pranishëm të tjerë: /**

Z-Petrushevski e hapi seancën e 40-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audi dhe Audiovizuele. Seanca filloi në ora 13:20 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri e miratoi:

**RENDIN E DITËS**

1. Miratim i Propozim-procesverbalit nga vazhdimi i parë i seancës së 37-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, e mbajtur më 6.10.2022.
2. Miratim i Propozim-procesverbalit nga vazhdimi i parë i seancës së 38-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, e mbajtur më 6.10.2022.
3. Miratim i Propozim-procesverbalit nga seanca e 39-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, e mbajtur më 6.10.2022.
4. Propozim-vendim për fshirjen nga regjistri i transmetuesve të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive televizion KANAL-21 SHPKNJP Veles.
5. Propozim për dhënie miratim për marrje të vendimit për furnizim të shërbimit –sigurim të përkthimit në gjuhën e shenjave maqedonisht, për personat e shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim, për pjesë të aktiviteteve gjatë Ditëve të arsimimit mediatik për vitin 2022, me vlerë të caktuar nën pragun e vlerës për zbatimin e Ligjit për furnizimet publike.
6. Propozim – udhëzim për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzuesit për përcaktim të afatit për veprimin sipas vendimeve të Agjencisë për marrjen e masës (Tekst i pastruar) nr.01-6039/1 datë 20.10.2015.
7. Propozim për marrje të procedurës për kundërvajte kundër TV Shutel për shkelje të nenit 50 paragrafi (3) të LSHMAAV dhe nenit 19 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve.

8. Propozim për marrje të procedurës për kundërvajtje kundër TV 21-M për shkelje të nenit 53 paragrafi (20 të LSHMAAV.
9. Propozim për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për pagën bruto dhe kompensime të tjera të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.
10. Propozim për dhënie miratim për zbatim të procedurës për furnizim publik – mallra: Sistem për udhëheqje (menazhim) automatik me dokumente.
11. Propozim për dhënie miratim për zbatim të procedurës për furnizim publik – shërbime: Mirëmbajta dhe servisimi i mjeteve motorike zyrtare.
12. Propozim – vendim për pagesën e dëmshpërblimit për vdekjen e anëtarit të familjes.
13. Të ndryshme.

### **Pika 1**

Këshilli i Agjencisë pasi shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin nga vazhdimi i parë i seancës së 37-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, e mbajtur më 6.10.2022, me tekst siç ishte propozuar.

### **Pika 2**

Këshilli i Agjencisë pasi shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin nga vazhdimi i parë i seancës së 38-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, e mbajtur më 6.10.2022, me tekst siç ishte propozuar.

### **Pika 3**

Këshilli i Agjencisë pasi shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin nga seanca e 39-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, e mbajtur më 6.10.2022, me tekst siç ishte propozuar.

### **Pika 4**

Z- Trajçevski arsyetoi Propozim-vendimin për fshirjen nga regjistri i transmetuesve të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive televizion KANAL-21 SHPKNJP Veles. Ai shpjegoi se tek ky transmetues para një kohe të caktuar është hapur procedurë falimentimi. Duke qenë se janë krijuar kushtet në lidhje me procedurën e falimentimit, dhe ndërkohë nuk ka transmetuar as programin që është konstatuar me vërejtje zyrtare të IT Sektorit, me deklaratë nga transmetuesi se ka ndërprerë transmetimin, dhe duke pasur parasysh mosparaqitjen dhe mosprezencën në seancën publike, e vetmja gjë që mbetet është t'i propozohet Këshillit të miraton vendimin për fshirjen nga regjistri i transmetuesve.

Z- Petrushevski tha se ky është vendim teknik, që është si pasojë e procedurës për falimentim dhe deklaratës së dhënë për ndërprerje të veprimtarisë. Ai mendon se deklarata është e qartë dhe nëse rikuperohet në të ardhmen transmetuesi mund të aplikojë dhe të rimëkëmb mediumin.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendimin për fshirjen nga regjistri i transmetuesve të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive televizion KANAL-21 SHPKNJP Veles.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Vendimin e mësipërm duhet ta publikojë në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“ dhe në ueb faqen e Agjencisë.

Z- Petrushevski uroi që të vijë kohë më të mira dhe në të ardhmen të rimëkëmb mendiumin, ndoshta edhe me të njëjtin emër.

## **Pika 5**

Z-Trajçevski e arsyetoi Propozimin për dhënien miratim për të sjellë vendim për furnizim të shërbimeve-ofrimin e përkthimit në gjuhën e shenjave në maqedonisht, për personat e shurdhër dhe me pengesa në dëgjim, për pjesë të aktiviteteve gjatë kohës së Ditëve të arsimimit mediatik për vitin 2022, me vlerë të caktuar nën pragun e vlerës për zbatimin e Ligjit për furnizim publik. Po ashtu sqaroi, me qëllim të realizimit të ngjarjeve të Ditëve të arsimimit mediatik për të qenë më të arritshme për këtë kategori qytetarësh, u propozua sigurimi i 8.400,00 denarëve që të mundësohet angazhim i përkthyesëve në gjuhën e shenjave.

Këshilli i Agjencisë njëzëri i dha miratim drejtorit të Agjencisë për të marrë vendim për furnizimin e shërbimit-ofrimin e përkthimit në gjuhën e shenjave në maqedonisht, për personat e shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim, për pjesë të aktiviteteve gjatë kohës së Ditëve të arsimimit mediatik për vitin 2022, me vlerë të caktuar nën pragun e vlerës për zbatim të Ligjit për furnizimet publike, në shumë të vlerës e cila nuk i kalon 8.400,00 denarë pa përfshirë TVSH-në.

Mjetet për shërbimin e mësipërm janë siguruar me Planin Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për 2022.

## **Pika 6**

Z-Trajçevski e arsyetoi Propozim-udhëzimin për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit për përcaktim të afatit për veprim sipas vendimeve të Agjencisë për marrjen e masave (Tekst i pastruar) nr.01-6039/1 datë 20.10.2015. Ai shpjegoi se ky dokument si projekt verzion është miratuar që në fillim të verës dhe për të ishte hapur debat publik i cila zgjati 75 ditë. Ai ka thënë se në mbledhjen e fundit publike të Agjencisë, e cila është mbajtur më 29 shtator janë ftuar të gjithë transmetuesit që të shprehin qëndrimet e tyre në lidhje me shkurtimin e afateve. Në këtë mbledhje publike ishte i pranishëm Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së dhe këshilltari Zoran Fidanoski. Të gjithë diskutuesit që ishin të pranishëm kanë deklaruar se nuk kanë vërejtje dhe theksuan se janë dakort për shkurtimin e afateve që të mund në periudhë sa më të shkurtër t'i mënjanojnë shkeljet pasi që afatet e gjata për harmonizimin me Ligjin mundësojnë që të lihen në haresë shkeljet dhe të befasohen kur do të marrin lajmërim për kundërvajtje. Gjithashtu, kur projekt verzioni u publikua në ueb faqe dhe u hap debat publik nuk arritën vërejtje nga askush.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Udhëzimin për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit për caktimin e afatit për veprim sipas vendimeve të Agjencisë për marrjen e masave (Tekst i pastruar) nr.01-6039/1 datë 20.10.2015, me teks siç është propozuar.

Udhëzimi për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për të vepruar sipas vendimeve të Agjencisë për marrjen e masave hyn në fuqi në ditën e miratimit, dhe do të zbatohet nga 1 janari 2023.

Spektori për çështje juridike dhe furnizim publik duhet të hartojë tekst të pastruar të Udhëzuesit për përcaktimin e afatit për veprim sipas vendimeve të Agjencisë për marrje të masave.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe të Këshillit duhet të publikojë udhëzimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

Z- Petrushevski pas votimit tha se transmetuesit duhet të informohen, edhe pse janë „për“ mirëpo nuk duhet të ketë prej tyre që nuk e dinë se këto afate janë shkurtuara, jo vetëm me publikimin në ueb faqe por duhet të njoftohen dhe me shkresë prej kur do të fillojë të zbatohet udhëzimi.

## **Pika 7**

Udhëheqësja e Sektorit për çështje programore mr.Emilija Janevska ka shpjeguar Propozimin për iniciimin e procedurës për kundërvajtje ndaj TV Shutel për shkelje të nenit 50 paragrafi (3) të LSHMAAV dhe nenit 19 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve. Ajo shpjegoi se kjo shkelje u konstatua nga mbikëqyrja e kontrollit e cila është realizuar nga regjistrimet e programit nga data 28 shtator deri më 6 tetor. Këtij transmetuesi më 26 gusht të këtij viti i është shqiptuar masë vërejtje publike për shkelje të nenit 50 paragrafi (3) të LSHMAAV dhe të nenit 19 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve dhe i është dhënë afat prej 30 ditësh për t'iu përmbajtur obligimeve ligjore. Nga mbikëqyrja u konstatuar se transmetuesi nuk ka vepruar sipas Vendimit për dhënien vërejtje publike, përkatësisht vazhdon të bëjë shkelje të njëjta të Ligjit dhe Rregullores për mbrojtjen e të miturve. Ndryshe nga këto dispozita më 28 shtator transmetuesi në disa programe artistike, „Zlostornikot“, „Me Deputeto“, „Vollshebnikot od Oz“, „Jackson comedy“, dy episode nga „Islamska serija“ dhe kamera e fshehtë „Gags-just for laughs“, janë transmetuar pa sinjalizimin përkatës para fillimit dhe pa shenjën klasifikuese për kategorin e programit gjatë gjithë kohëzgjatjes, ndërsa filmi artistik i luajtur „Ljuboven roman“ është transmetuar pa sinjalin paralajmërues para fillimit të transmetimit. Për këtë arsye është propozuar të ngrihet procedurë për kundërvajtje pranë gjykatës kompetente.

Këshilli i Agjencisë pasi shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore me nr.10-3752/1 datë 6.10.2022 ndaj Shoqërisë Tregtare me veprimtari radio-difuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup i konstatoi shkelje të nenit 50 paragrafi (3) nga LSHMAAV dhe nenit 19 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve.

Këshilli njëzëri solli përfundim se ndaj Shoqërisë Tregtare për veprimtari radio-difuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup të ngrihet procedurë për kundërvajtje pranë gjykatës kompetente sepse nga kontrolli i mbikëqyrjes u konstatua se më 28 shtator 2022, në programet e transmetuara: „Zlostornikot“, „Me Deputeto“, „Vollshebnikot od Oz“, „Jackson comedy“, dy episode nga „Islamska serija“ dhe kamerës së fshehtë „Gags – just for laughs“ janë transmetuar pa sinjalizimin përkatës para fillimit dhe pa shenjën klasifikuese për kategorinë e programit gjatë gjithë kohëzgjatjes, ndërsa në filmin e luajtur „Ljuboven roman“ është transmetuar pa sinjalin paralajmërues para fillimit të transmetimit.

Spektori për çështje juridike dhe furnizim publik duhet të përgatisë Kërkesën për fillimin e procedurës për kundërvajtje pranë gjykatës kompetente për transmetuesin në fjalë.

## **Pika 8**

Z-Trajçevski shpjegoi Propozimin për inicimin e procedurës për kundërvajtje kundër TV 21-M për shkelje të nenit 53 paragrafi (2) të LSHMAAV. Në lidhje me këtë raport ai shpjegoi se është mbajtur mbledhje ndërmjet tij, bashkëpunëtorit të lartë nga Sektori për çështje programore Viktor Shikov dhe drejtorin e televizionit z-Valon Saraçini. Nga kjo mbikëqyrje kontrolli, përsëri është konstatuar se transmetuesi vazhdon të kryejë shkelje nga neni 53 paragrafi (2) të LSHMAAV përkatësisht nuk ka respektuar ndalesën për komunikim komercial audiovizual të fshehur gjegjësisht ndalesën për fshehtësi të reklamave. Jo vetëm në ditën e cekur kur është kryer mbikëqyrja por edhe në ditët në vijim në emisionet që janë të shënuara me prodhime që plasohen (reklamohen), prezantuesja e këtij emisioni ose prezantuesit e emisioneve të tjera në kuadër të madh (gjerë) kanë prezantuar prodhime që janë mjete për reklamim, flasin në superlatif për to dhe në njërin nga emisionet prezantuesja ka përdorur edhe aparatën. Nga Sektori për çështje programore kanë kontaktuar disa herë dhe me redaktorin përgjegjës përkatësisht me drejtorin e programit dhe me gazetaren e këtij emisioni dhe nga ana e tyre nuk është vepruar sipas indikacioneve të Agjencisë. Në takimin që kishin me drejtorin, Viktor Shikov prezantoi se si mund të realizohen emisione të tilla dhe shpreson që në periudhën në vijim kjo shkelje do të mënjanohet pasi që drejtori i televizionit e ka pasur plotësisht të qartë se në çfarë mënyre mund të realizojë këtë lloj të programeve pa shkelur LSHMAAV.

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të kontrollit programor nr.10-3762/1 datë 7.10.2022 të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive KOMPANI 21 – M SHPKNJP Shkup dhe konstatoi shkelje të nenit 53 paragrafi (2) të LSHMAAV.

Këshilli i Agjencisë njëzëri konkludoi kundër Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive KOMPANI 21 – M SHPKNJP Shkup të ngrihet procedurë për kundërvajtje pranë gjykatës kompetente sepse nga mbikëqyrja e kontrollit u konstatua se në 23 shtator 2022, në programin guvernata-shou me funksion argëtues mediatik „Pastel“, u transmetua komunikim i fshehtë komercial audiovizual i prodhimeve kozmetike nga „JM Organiks“.

Sektori për çështje juridike dhe furnizim publik duhet të përgatisë Kërkesë për fillimin e procedurës për kundërvajtje pranë gjykatës kompetente për transmetuesin në fjalë.

## **Pika 9**

Z- Trajçevski shpjegoi Propozimin për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për pagën bruto dhe kompensime të tjera të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Shpjegoi se në njërin prej seancave të mëparshme, pas propozimit të paraqitur Këshilli votoi për pozicion të ri në vendin e punës si Bashkëpunëtor i lartë për përkrahje informative dhe çështje të përgjithëshme, dhe në pajtim me të është përcaktuar dhe numri i bodeve për të njëjtën.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për pagën bruto dhe kompensime të tjera të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, me tekst siç ishte propozuar.

Sektori për çështje juridike dhe furnizim publik duhet të përgatisë tekst të pastruar të Rregullores për pagën bruto dhe kompensime të tjera të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Akti nënligjor i mësipërm të publikohet në tabelën e shpalljeve të Agjencisë.

### **Pika 10**

Z-Trajçevski shpjegoi Propozimin për dhënie miratim për zbatimin e procedurës për furnizim publik-mallra: Sistem për udhëheqjen automatike të dokumenteve. Ai shpjegoi se ky furnizim publik është shpallur edhe vitin e kaluar, por nuk është realizuar. Kishte kritere mjaft strikte dhe nga tre kompanitë që aplikuan asnjëra nuk i plotësonte kriteret. Njëra nga kompanitë është ankuar në Komisionin e Ankesave të Furnizimit Publik, por komisini ka konfirmuar vendimin e Agjencisë. Sektori për mbështetje informative dhe punë të përgjithëshme ka përgatitur dokumentacionin e tenderit dhe këtë radhë ka vendosur kushte pak më liberale, kështu që pritet që të paraqitet një numër më i madh i kompanive që mund të plotësojnë kushtet dhe të realizojnë këtë furnizim publik.

Z-Petrushevski tha se ka shikua specifikacionin teknik, i cili është shkruar në mënyrë mjaft solide dhe mendon se në Maqedoni janë ndoshta 5 kompani që mund t'i plotësojnë kushtet. Ai shpreson se do të telefonojnë në atë numër dhe me konkurrencë të mirë do të arrihet çmimi më i ulët i mundshëm.

Z-Fidanoskie pyeti drejtorin nëse ajo që ai shpjegoi lidhur me kushtet më liberale nënkupton raportin e çmimit 70 pikë dhe cilësinë 30 pikë dhe nëse mendon se me këtë raport, të cilin dhe ai personalisht e konsideron të mirë, a do të ketë një furnizim publik të suksesshëm?

Z-Trajçevski sqaroi se më konkretisht për specifikacionin teknik mund të përgjigjet udhëheqësi i Sektorit për mbështetje informatike dhe punë të përgjithëshme mr. Arben Saiti. Ai ka shpjeguar se disa çertifikata që është dashur t'i plotësojnë kompanitë vitin e kaluar janë hequr sepse vetëm tre kompani i kanë plotësuar këto kërkesa, ndërsa pjesën tjetër e kompanive nuk kanë mundur t'i plotësojnë. Po ashtu kemi informacion se njëra prej këtyre kompanive, e cila vitin e kaluar ka marrë pjesë në furnizimet publike në disa institucione të mëdha ku ka marrë furnizime publike, nuk e ka realizuar dhe për këtë është ndërprerë kontrata.

Udhëheqësi i Sektorit për mbështetje informatike dhe punë të përgjithëshme mr. Arben Saiti shpjegoi se gjatë përgatitjes së specifikacionit teknik kësaj radhe qasja ka ndryshuar pak në krahasim me vitin e kaluar, mbi të gjitha në lidhje me çertifikatat e punonjësve apo personave që duhet të kyçen në projekt. Gjithashtu, numri i referencave ka rënë pas një sugjerimi nga trajnimi i zhvilluar pak kohë më parë në Agjenci me Byronë për furnizim publik. Sa i përket qasjes, ky specifikim përfshin të gjitha procedurat ISO që ka Agjencia, kështu që shpresohet që i gjithë procesi i punës në Agjenci të digjitalizohet me tendencë për përdorim minimal të letrës sepse do të përdoret vetëm për dokumentet përfundimtare. Ai bën me dije se Sektori ka bërë një hulumtim të vogël dhe ka kuptuar se shumë institucione shtetëror janë duke futur këtë sistem për menaxhimin automatik të dokumenteve.

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratim për zbatimin e procedurës për furnizim publik për mjetin e radhës të furnizimit publik-mallra: Sistemi i menaxhimit automatik të dokumenteve.

Zbatimi i procedurës së furnizimit publik për sistemin e mallrave për menaxhim automatik të dokumenteve është paraparë dhe është në pajtim me Planin vjetor të furnizimit publik për vitin 2022 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Tekst i

pastruar) nr.05-3616/1 datë 30.9.2022, ndërsa mjetet janë siguruar me Planin Finasiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për 2022.

### **Pika 11**

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe punë të përgjithshme Cvetanka Mitrevska ka shpjeguar Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbime: Mirëmbajtja dhe servisimi i mjeteve motorike zyrtare. Sqaroi se bëhet fjalë për furnizime me vlerë të vogël që Agjencia e zbaton në pajtim me praktikën prej 2 vitesh. Furnizimi (blerja) është e nevojshme për të garantuar sigurinë dhe mbajtjen e automjeteve që janë në pronësi të ASHMA-së. Sipas vlerës së parashikuar furnizimi do të bëhet si furnizim me vlerë të vogël në pajtim me dispozitat e Ligjit për furnizime publike, që do të thotë se njoftimi për këtë furnizim publik do të publikohet vetëm në sistemin elektronik për furnizim publik ndërsa mjete financiare janë siguruar me Planin financiar të Agjencisë për Shërbime mediatike Audio dhe Audiovizuele për 2022, pra do të parashikohen (sigurohen) në Planin financiar të Agjencisë për 2023.

Z-Petrushevski tha se në pajtim me materialet nga pika janë paraparë 550.000,00 denarë për 2 vite përkatësisht nga 275.000,00 denarë në vit.

Z-Fidasoski tha se do të mbështesë këtë furnizim publik dhe vlerëson se shuma është adekuate duke pasur parasysh me sa jam i informuar se shumica e makinave zyrtare janë në përdorim (shfrytëzim) më shumë se 10 vjet por janë në gjendje të mirë dhe të mirëmbajtura. Duke njohur tregun se sa kushton servisimi (shërbimi) apo riparimi i automjeteve, ai mendon se çmimi është absolutisht adekuat dhe do të ofrojë mbështetje.

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratim për zbatimin e procedurës për furnizim publik për lëndën e radhës të furnizimit publik – shërbim: Mirëmbajtja dhe servisimi i mjeteve motorike zyrtare, për 2 (dy) vjet.

Zbatimi i procedurës së furnizimit publik për lëndën-shërbime: Mirëmbajtja dhe servisimi i mjeteve motorike zyrtare, për 2 (dy) vjet është paraparë dhe është në pajtim me Planin vjetor për furnizime publike për 2022 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Tekst i pastruar) nr.05-3616/1 datë 30.9.2022, dhe mjetet sigurohen nga Plani Finasiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për 2022, përkatësisht do të sigurohen në Planin Finasiar të Agjencisë për 2023.

### **Pika 12**

Këshilli i Agjencisë njëzëri i dha miratim drejtorit të Agjencisë të marrë Vendim për pagesën e ndihmës financiare – kompensim për vdekjen e anëtarit të ngushtë të familjes (babait), punonjësit të caktuar në vendin e punës në Sektorin për mbështetje informative dhe çështje të përgjithshme në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në shumë prej 15.000,00 (pesëmbëdhjetë mijë) denarë.

Mjetet (fondet) e mësipërme sigurohen me Planin Finasiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2022.

### **Pika 13**

**Të ndryshme**

Nuk kishte diskutim nën Të ndryshme.

**Nr.02-3850/11**

**03.11.2022**

**Shkup**

**Agjencia për Shërbime  
Mediatike Audio dhe Audiovizuale**

**Kryetari i Këshillit  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v**